# DËSHMI ARKIVI

**A-476937**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Agron Shehaj në Konferencën Ndërparlamentare me BE: Ju dhe SHBA investuat te drejtësia, Rama i ka shpallur luftë |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/agron-shehaj-ne-konferencen-nderparlamentare-me-be-ju-dhe-shba-investua-i106443` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 16:12:02 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 16:08:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8193b6d57de61d9a00fdda4646250d087b0707e5a011fbffb586631082e5fe26` |
| TEKSTI | `70a74d4fed6966bcb6e57a94e7885226bc38cbfa6f79867e5246f3a2db34fab5` |
| PAMJA | `a58c90756ebbd6e5fd18ee06271fc4223ac321f6a5047849502de480f36a7dca` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f6bda566b3f15d264a5e5cd8051d4c3baf6b5ce36957556a7fd303e9e0a6b4cc` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcecb101e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f6bda566b3f15d264a5e5cd8051d4c3baf6b5ce36957556a7fd303e9e0a6b4cc`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# Agron Shehaj në Konferencën Ndërparlamentare me BE: Ju dhe SHBA investuat te drejtësia, Rama i ka shpallur luftë

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 18:08



Kryetari i Partisë Mundësia, Agron Shehaj, ngriti në Konferencën Ndërparlamentare me Bashkimin Europian shqetësimin për atë që e cilësoi si një "luftë të paprecedentë" ndaj drejtësisë në Shqipëri, duke paralajmëruar se po rrezikohet një nga investimet më të rëndësishme të BE-së dhe SHBA-së në vend. Shehaj tha se shqiptarët e shohin integrimin europian si shpresën për garantimin e të drejtave të tyre dhe theksoi se procesi i anëtarësimit nuk duhet të ndalet.

"Sigurisht shqiptarët duan Bashkimin Europian. Absolutisht. Nuk e duan vetëm sepse mendojnë që Shqipëria është pjesë e Europës por se e shikojnë si shpresë. Shikojnë dhe mendojnë dhe shpresojnë që ditën që Shqipëria do të jetë pjesë e BE më në fund ata do të kenë të drejta, do t'u njihen të drejtat. Kjo është ëndrra e madhe e shqiptarëve. T'u njihen të drejtat", deklaroi Shehaj.

Sipas tij, pikërisht në këtë moment rrezikohet një prej investimeve kryesore të partnerëve ndërkombëtarë në Shqipëri: sistemi i ri i drejtësisë.

"Dhe arsyeja pse për mua ishte shumë e rëndësishme të flisja para jush është sepse nuk do sot po rrezikojmë një nga investimet më të rëndësishme që ka bërë BE me ndihmën dhe të SHBA të bllokohet, të ndalet. Sepse drejtësia nuk është thjesht nën presion. Drejtësisë po i bëhet një luftë e paprecedentë", tha ai.

Shehaj akuzoi mazhorancën dhe kryeministrin Edi Rama se sulmojnë drejtësinë sa herë që përfaqësues të pushtetit përballen me hetime apo akuza për korrupsion.

"Kryeministri i Shqipërisë, ju e keni dëgjuar në këto konferenca sesi flet për drejtësinë por ju nuk keni parë anën tjetër të medaljes, se si flet kryeministri i Shqipërisë kur iu flet shqiptarëve, se si i sulmon ata nëpërmjet mediave të tij, në mënyrë të përditshme. Çdo herë që ata nxjerrin para drejtësisë përfaqësuesit e kësaj mazhorance dhe i akuzon për korrupsion Edi Rama del dhe sulmon drejtësinë", deklaroi kreu i Mundësisë.

Ai iu referua gjithashtu përplasjes për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke e paraqitur atë si pjesë të presionit ndaj sistemit të drejtësisë.

"Arriti deri aty sa nuk u pagoi pagat. Sepse Edi Rama mendon që pagat për një prokuror, për një gjyqtar, janë si pagat e tyre, si pagat e politikanëve të korruptuar që kanë qeverisur këtë vend këto 35 vjet. Ata nuk kanë nevojë për paga sepse janë të papërfillshme në krahasim me përfitimet që kanë nga pushteti. Por drejtësia sigurisht nuk është e kulluar. Po aty ka prokurorë dhe gjykatës që me ato paga jetojnë", u shpreh Shehaj.

Në fjalën e tij, Shehaj foli edhe për protestat që vijojnë prej më shumë se tre muajsh në Tiranë dhe për problemet që, sipas tij, qytetarët shqiptarë hasin në garantimin e të drejtave themelore.

"Duhet të kuptoni të nderuar miq të Shqipërisë që Shqipëria fatkeqësisht është vend i padrejtësive. Dhe ashtu si unë si kryetari i një partie opozitare duhet të luftoj për fjalën e lirë për të bërë opozitë, ashtu çdo qytetar shqiptar lufton çdo ditë për të drejtat themelore që ju as nuk mund ta imagjinoni", tha ai.

Shehaj e mbylli fjalën duke falënderuar përfaqësuesit europianë për mbështetjen ndaj procesit të integrimit të Shqipërisë.

"Ju falënderoj që jeni këtu dhe që vazhdoni dhe besoni pavarësisht problemeve, që Shqipëria duhet të jetë pjesë e BE."

## Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 28 Shtator17:55

**Debate te "Ligjet" për territorialen/ Brahimi: Bashkimi i bashkive ul kostot me mbi 30%. Korreshi: Ky po tall by***n, po e bëni për të grumbulluar votat e PS**

Diskutimet për reformën territoriale kanë shkaktuar debate në Komisionin e Ligjeve mes drejtorit të Financave në Ministrin&eu...

POLITIKE 28 Shtator17:10

**Kreu i ri i SHISH (i komanduar) shfaqet për herë të parë në publik në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë: Kush është Elvis Lila?**

U mbajt sot pas tri vitesh, mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, i thirrur nga presidenti Bajram Begaj, pas skandalit në SHISH.&...

POLITIKE 28 Shtator16:37

**Gazetari nga Kosova shkruan për dy rusët që urdhëruan Vlora Hysenin të vëzhgonte diplomatin amerikan**

Fitim Çeku, një gazetar shqiptar nga Kosova ka publikuar dokumentet e nxjerra nga rrjeti i hakerave "Homeland Justice", i cili nga autoritetet n&eum...

POLITIKE 28 Shtator16:23

**“Shefja e Shërbimit pjesë e grupit të Beqirit dhe Agasit”/ Salianji: Shërbente si hartë ku të fshiheshin kokat e krimit**

Ish-deputeti i PD-së Ervin Salianji ka folur mbi skandalin e ish-drejtoreshës së SHISH, Vlora Hyseni. Salianji theksoi se ajo bënte pjes&eum...

POLITIKE 28 Shtator15:39

**Deklaratat e Ramës nga Rinasi, Erl Murati: Spektakël, kryeministri ishte i nervozuar**

Analisti Erl Murati ka komentuar zhvillimet e fundit lidhur me dosjen e Vlora Hysenit, duke u ndalur te masa “arrest në shtëpi”, por edhe ...

POLITIKE 28 Shtator15:31

**Bardhi takon Ambasadoren e re të Holandës në Shqipëri: Krimi dhe korrupsioni kanë kapur shtetin**

Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi ka zhvilluar një takim me ambasadoren e Mbretërisë së Holandës në Shq...

POLITIKE 28 Shtator15:13

**Zhupa: I vetmi akt që i shërben sigurisë kombëtare është dorëheqja**

Kryetarja e Komisionit të Kulturës, Turizmit dhe Diasporës Ina Zhupa e nisi mbledhjen me një debat të fortë me socialistët p&...

POLITIKE 28 Shtator14:44

**Deklaratat skandaloze të kryeministrit, Garo: Edi Rama bëri sot, akt shantazhi politik në zemër të Europës**

Pas deklaratave skandaloze të kreut të qeverisë shqiptare gjatë ditës së sotme, ka reaguar Partia Demokratike. Sipas zëdh&...

POLITIKE 28 Shtator14:17

**Luftë për “Territor”/ “Doni ta votoni hartën e re për ta pasur për zgjedhjet!”, Bozdo thirrje PS: Lërini urdhrat politikë!**

Deputeti i Partisë Demokratike, Enno Bozdo, ka kundërshtuar në Komisionin e Ligjeve mënyrën se si mazhoranca po procedon me reform&eu...

POLITIKE 28 Shtator12:48

**Blushi te Ligjet: Sot në konsultë, subjekte të filmave të Gysit. Harta e PS si tenderat e paracaktuar të Ramës e Ballukut**

Kreu i grupit parlamentar të PL-së, Tedi Blushi kundërshtoi në Komisionin e Ligjeve projektin e PS-së për reformën ter...

## ME TE VIZITUARAT

LIFESTYLE 28 Shtator

**Horoskopi/ Dashuria, financat dhe surprizat që ...**

Dashi Ata që janë në një lidhje nuk duhet të nxitohen për asgjë. Për gjithçka do të bëjnë mir&e...

AKTUALITET 27 Shtator

**I martuar me një grua ruse, si u kap gafil elba...**

Detaje të reja kanë dalë nga operacioni, për kapjen në Rusi të Salvatore alias Shpëtim Aliut në Federatën Ruse, ku ...

AKTUALITET 27 Shtator

**Lulëzimi i çiftit Ergys dhe Dorina Verdho/ Nga ...**

Çifti Ergys dhe Dorina Verdho duhet të merret si “shembull” nga familjet shqiptare për mënyrën sesi kanë shumëf...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

**Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!**

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

## video



## PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2**



**Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!**



**Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.